



NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES

PRN142 Ndërmarrja Shoqërore " Rilindja Gazeta " Prishtinë

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

OTHPB Gazeta "Rilindja" Prishtinë, në përbërje të NIGRO "Rilindja" në Prishtinë, 1978
NIGRO "Rilindja", OTHPB Redaksia-Gazeta, Prishtinë, 1985
Ndërmarrja e Përbëre "Rilindja", me përgjegjësi të plotë, Pallati i Shtypit Prishtinë, 1990
Ndërmarrja Shoqërore Gazetare "Rilindja" (Novinska Društvena Proizvedica "Rilindja"), 1990
N.I.B. "Rilindja" Pallati i Shtypit, Prishtinë, (Regjistrimi i Bizneseve nga Administrata e
përkohshme Civile e UNMIK-ut), 2000.
Fi-286/90 me datën 22.04.1990

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 22 shkurt 2017 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 30 janar dhe 14 shkurt 2017.

Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes duhet të parashtrojë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.

Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 08 mars 2017 dhe përfundon me datë 24 prill 2017 në orën 16:00.

Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta kenë informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje të kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.

Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit Zyra Rajonale në Prishtinë
rr. Rexhep Mala, nr. 2
Prishtinë, 10 000
Telefoni: +381 38 226 889

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit të AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni **"Formularët-Udhëzime për plotësim"**. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.